

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE

AGJENCIA KOMBËTARE E AFTËSIVE DHE PUNËSIMIT

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "MIHAL SHAHINI" CERRIK

Nr. 560 Prot

Cerrik me 29 / 09 / 2023

Lënda : Njoftim për vend te lire

Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë kombëtare të Punësimit dhe Aftësie

Në zbatim të Ligjit nr 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", te Ligjit 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë" , të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 554, datë 31.07.2019 "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive " , të Udhëzimit Nr 14 , datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit profesional si dhe aspekte të menaxhimit të burimeve , përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" ,

Shkolla e mesme profesionale "Mihal Shahini", Cerrik , njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionet :

1(një) Mësues të teorisë profesionale me kohë të pjesshme për lëndët Baza sipërmarrje

1(një) Mësues i teorisë profesionale me kohë të pjesshme në drejtimin Teknologji ushqimore

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti për mësues të teorisë profesionale me kohe te pjesshme duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lire si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësimdhënës të teorisë profesionale me kohe te pjesshme duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së
- b) të ketë të paktën 1 (vit) përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin
- Jetëshkrimin (CV-në)
- Kartën e identitetit
- Diplomën
- Librezën e punës
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

3. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

4. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së , brenda dates
12.10.2023

Drejtori i shkollës

ERINA DISHO

